



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORATI

Nr. 2734 Prot.

Tiranë, më 15.10.2021

VENDIM

Nr. 11, datë 14.10.2021

**“Për fillimin e procesit mësimor për vitin akademik 2021-2022, në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të dytë”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 40; në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 36, si dhe në Urdhrin nr. 166, datë 17.06.2021 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për caktimin e datës së fillimit dhe mbarimit të vitit akademik 2021-2022, në IAL”, i ndryshuar, në mbledhjen e datës 14.10.2021, Rektorati i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Të gjitha njësitë përbërëse të Universitetit të Tiranës, të cilat ofrojnë programe studimi të ciklit të dytë, për vitin akademik 2021-2022, të fillojnë procesin mësimor për vitin e parë, jo më vonë se data 10 nëntor 2021.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, dekanatet e njësive kryesore dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, pranë Rektoratit të UT-së.
3. Vendimi t’u përcillet të gjithë njësive përbërëse për zbatim.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORATI  
Prof. Dr. Artan Dioxha